

PARALAJMËRIME DHE UDHËZIME PËR SIGURINË

- Lexoni me kujdes gjithë manualin dhe ruajeni për referenca të mëvonshme.
- Përdoreni vetëm për qëllimet e përcaktuara. Mosrespektimi i udhëzimeve të përdoruesit mund të shkaktojë lëndime për përdoruesin ose dëmtim të produktit.
- Ky pajisje është i destinuar vetëm për përdorim shtëpiak.
- Këtë pajisje mund ta përdorin fëmijët nga mosha 8 vjeç e lart si dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, shqisore apo mendore ose me mungesë përvoja dhe njohurie nëse janë nën mbikëqyrje ose janë udhëzuar në mënyrë të sigurt për përdorimin e pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të kryhen nga fëmijët përveç nëse janë më të mëdhenj se 8 vjeç dhe janë nën mbikëqyrje.
- Shmangni që pajisja të bjerë në tokë apo të dëmtohet në çfarëdo mënyre.
- Mos tentoni të bëni ndonjë modifikim apo riparim vetë; riparimet duhet të kryhen vetëm nga teknikë të kualifikuar.
- Mos e përdorni pajisjen kur keni duart e lagura.
- Gjatë karikimit, futeni ose hiqeni kabllon me kujdes për të shmangur dëmtimin e portës së karikimit.
- Shkëputeni kabllon e karikimit menjëherë pas përfundimit të karikimit.
- Mos e përdorni ose karikoni pajisjen në mjedise me temperaturë të lartë, lagështi të lartë, tym ose pluhur të tepërt, si banja, sauna ose pranë flakëve të hapura.
- Përdorni vetëm karikuesin e specifikuar për të shmangur dëmtimin e pajisjes. Karikimi i papërshtatshëm mund të dëmtojë pajisjen. Kapërcimi i fuqisë hyrëse të rekomanduar mund të dëmtojë baterinë e integruar, gjë që mund të shkaktojë lëndime për përdoruesin.
- Mos përdorni aksesore të tjerë përveç atyre që janë furnizuar me pajisjen.
- Mos e përdorni pajisjen në ambiente të jashtme.
- Mos e zhytni në ujë dhe mos e ekspozoni ndaj lëngjeve apo lagështisë. Mbajeni pajisjen larg mjediseve me temperaturë të lartë.
- RREZIK MBYTJEJE:** Mbajeni pajisjen larg fëmijëve.
- RREZIK GODITJEJE ELEKTRIKE:** Afërsia me ujin përbën rrezik edhe kur pajisja është e fikur.
- MOS modifikoni, çmontoni, shponi, prisni ose digjni baterinë. MOS saldoni drejtpërdrejt në bateri, mos e ekspozoni ndaj temperaturave të larta, mos tentoni ta modifikoni ose ta hiqni nga produkti. Në rast dëmtimi të baterisë, çmontojeni dhe hidhni produktin menjëherë dhe në mënyrë të sigurt.
- Vendoseni pajisjen mbi sipërfaqe rezistente ndaj zjarrit për të minimizuar mundësinë e ndonjë incidenti me baterinë.
- UDHËZIME PËR SIGURINË NË RAST TË DËMTIMIT TË BATERISË:** Nëse bie në kontakt me elektrolitin e baterisë, shpëlajeni menjëherë me ujë dhe/ose kontaktoni menjëherë shërbimet e emergjencës. Nëse elektroliti bie në kontakt me sytë, shpëlajini me ujë për 15 minuta dhe kërkonti ndihmë mjekësore menjëherë.
- Përdorni një leckë të thatë ose pak të lagur, të butë për pastrimin e pajisjes. Mos e pastroni pajisjen me kimikate gërryese dhe mos e zhytni në ujë apo lëngje të tjera.
- Kontrolloni rregullisht kabllot, pjesët lidhëse dhe komponentët e tjerë për dëmtime. Nëse vini re ndonjë dëmtim, ndaloni menjëherë përdorimin dhe çojeni pajisjen për riparim në një shërbim profesional. Mirëmbajtja e rregullt ndihmon në reduktimin e plakjes dhe fryrjes së baterisë.
- Ky produkt nuk është lodër! Për të shmangur rrezikun nga zjarri, djegiet, goditjet elektrike ose lëndime të tjera, ruajeni dhe vendoseni pajisjen larg fëmijëve.
- Mos e përdorni këtë pajisje nëse nuk funksionon siç duhet, nëse ka rënë, ka shenja dëmtimi fizik, ka qëndruar jashtë ose ka qenë në kontakt me ujë.

UDHËZIME PËR RICIKLININ DHE ASGJËSIMIN:



Kjo etiketë tregon se produkti nuk mund të hidhet si mbeturina të tjera shtëpiake në të gjithë BE-në. Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të mjedisit ose të shëndetit të njeriut nga eliminimi i pakontrolluar i mbetjeve. Ricikloni në mënyrë të përgjegjshme për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve materiale. Nëse dëshironi të ktheni një pajisje të përdorur, përdorni sistemin e grumbullimit dhe dorëzimit ose kontaktoni shitësin nga i cili e keni blerë produktin. Shitësi mund ta pranojë produktin për riciklim të sigurt për mjedisin.



Deklaratë nga prodhuesi se produkti është në përputhje me kërkesat e direktivave të zbatueshme të BE-së.